



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME
AGJENCIA E ADMINISTRIMIT TË PASURIVE TË SEKUESTRUARA DHE TË KONFISKUARA

1. Shpallet 1(një) vend vakant i punës me kontratë, ndihmës administrator i pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara, pranë Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (AAPSK).

- Ndhmës administrator i pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara me profil shkenca juridike.

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin: “Ndhmës administrator i pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara me profil shkenca juridike”:

- Hartimin e pasaportave të pasurive, me informacion të azhornuar, për pasuritë ekzistuese dhe ato të reja, të administruara nga Administratori i pasurisë tek i cili përgjigjen.
- Hartimin dhe konceptimin e shkresave të administruara, të cilat i përcillen administratorit për konfirmim dhe miratim.
- Administratori dhe Ndhmës administratori, përgatisin procesverbalet për inventarizimet e pasurive dhe përgatisin raportin mujor mbi administrimin e pasurive.
- Asiston Administratorin në realizimin e detyrave të parashikuara në rregulloren e brendshme të AAPSK-së dhe akteve ligjore dhe nën ligjore në fuqi.
- Ndjekjen e procedurave për finalizimin e kontratave të qerasë.
- Hedh të dhënat në regjistrin elektronik të pasurive;
- Kryen çdo detyrë tjetër të përcaktuar për pozicionin e tij në rregulloren e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë.
- Merr pjesë dhe kontrollon pasuritë në administrim të administratorit.
- Si dhe detyra të tjera të ngarkuara nga administrator i pasurisë dhe të parashikuara në ligjin nr. 34/2019 “Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara”, i ndryshuar dhe rregulloren e brendshme të Agjencisë.

2. Kriteret që duhet të plotësojnë aplikantët për këtë pozicion.

Kritere të përgjithshme:

- Të jetë shtetas shqiptar dhe të njohë mire gjuhën shqipe
- Të ketë integritet të lartë profesional e moral;
- Të mos jetë i/e dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës;
- Të mos jetë përjashtuar/shkarkuar nga administrata publike;
- Të ketë aftësi të mira komunikimi dhe të punuarit në grup;
- Të ketë njohuri të programeve bazë të kompjuterit.
- I gatshëm në cdo kohë për lëvizje jashtë Tiranës.

3. Kriteret të posaçme: Të plotësojë kërkesat për nivelin e arsimit, përvojës dhe kërkesat e tjera për pozicionin përkatës.

Arsimi: Të ketë diplomë të nivelit “*Bachelor*”, në shkenca juridike. Diploma e nivelit Master ose kualifikime shtesë përbëjnë avantazh.

Përvoja: Nuk kërkohet përvojë. Të ketë eksperiencë të mëparshme në këtë profil/profesion, përbën avantazh.

4.Fusha e njohurive, aftësitë dhe cilësitë mbi të cilat do të zhvillohet intervista.

Kandidatët do të testohen/intervistohen në lidhje me:

- Njohuri të përgjithshme për Kodin e Punës për të drejtat e detyrimet e Punëdhënësit e Punëmarrësit;
- Njohuri mbi ligjin nr. 34/2019 “Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara” i ndryshuar;
- Në mbështetje të Ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009, i ndryshuar “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”;
- Ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, i ndryshuar;
- Ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” ;
- Ligjit nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”, i ndryshuar.

5. Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit të aplikimeve dhe zhvillimi i intervistës për përzgjedhjen e kandidatëve:

5.1 Aplikantët brenda 10 ditëve kalendarike nga data e shpalljes, duhet të dorëzojnë dokumentet pranë AAPSK:

1. *Kërkesë për punësim;*
2. *Jetëshkrim;*
3. *Diplomë e noterizuar e arsimit të lartë;*
4. *Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);*
5. *Fotokopje të letërnjoftimit (ID);*
6. *Vërtetim të gjendjes shëndetësore;*
7. *Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore/dëshmi penaliteti;*

Dokumentacioni i aplikantit duhet të dorëzohet në protokollin e AAPSK brenda datës **08.06.2026**.

5.2 AAPSK brenda datës **12.06.2026**, bën verifikimin paraprak të dosjeve të aplikantëve nëse plotësojnë kriteret specifike, të përcaktuara në këtë urdhër. Në përfundim të këtij afati, AAPSK njofton dhe shpall, listën e kandidatëve që plotësojnë këto kriteret për t’iu nënshtruar konkursit, duke i renditur ata sipas rendit alfabetik.

5.3 Kandidatët që nuk kanë plotësuar kriteret specifike, njoftohen nga Komisioni “Ad-Hoc” dhe kanë të drejtë të paraqesin ankim brenda 2 (dy) ditëve nga njoftimi. AAPSK duhet të shqyrtojë dhe të kthejë përgjigje të arsyetuar në rast se ka ankesa nga kandidatët e skulifikuar brenda 5 ditëve kalendarike.

Me përfundimin e shqyrtimit të ankesave, AAPSK shpall listën e kandidatëve që do i nënshtrohen procedurës së konkurrimit.

5.4-Fushat e njohurive, aftësitë dhe cilësitë mbi të cilat do të zhvillohet konkurrimi janë bazuar në:

- a) Vlerësimin e jetëshkrimit dhe letër motivimit (10 Pikë)
- b) Testimi me shkrim (40 Pikë)
- c) Intervista e strukturuar me gojë (50 Pikë)

5.5-Zhvillimi i testimit dhe intervistës me aplikantët e përzgjedhur nga komisioni “Ad-Hoc” do të kryhet brenda datës **17.06.2026**, në Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara.

5.6-Kandidatët do të njoftohen mbi vlerësimin brenda 2 ditëve nga përfundimi i intervistës.

5.7- Kandidatët që nuk janë shpallur fitues, kanë të drejtë të ankohen me shkrim pranë AAPSK, brenda 3 ditëve nga shpallja e rezultatit.

5.8-Ankuesi merr përgjigje brenda 2 ditëve kalendarike nga përfundimi afatit të ankimit.

5.9- Shpallja e fituesit bëhet brenda 7 ditëve nga përfundimi i intervistës.

5.10- Fitues shpallet kandidati që ka fituar pikët më të larta në listen e kandidatëve fitues me mbi 70 pikë.